

RAPORTI VJETOR I PUNËS DHE REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS PËR VITIN 2024

Kuvendi i Komunës së Graçanicës është organ më i lartë përfaqësues i komunës, i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës në zgjedhjet lokale. Kuvendi i Komunës së Graçanicës funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Statutit dhe akteve nënligjore. Në përputhje me kompetencat e tij, Kuvendi i komunës miraton aktet e mëtejme: Statutin, Rregulloren e punës, rregulloret, vendimet dhe udhëzimet dhe ndërmerr masa të nevojshme për zbatimin e tyre me qëllim të realizimit të kompetencave të komunës.

Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka 19 asamblastë, mandati i të cilëve zgjat 4 vjet. Pas formimit, përbërja e subjekteve politike të asamblastëve të Kuvendit të komunës 2021/22-2025 është:

18 asamblastë LISTA SERBE

1 asamblast ALEANCA SHQIPTARE

Mbledhjet e Kuvendit të komunës

- ✓ Në vitin 2024, Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka mbajtur gjithsej 16 mbledhje, nga të cilat: 9 të rregullta, 5 të jashtëzakonshme dhe 2 solemne.

Të gjitha mbledhjet ishin transparente për publikun, në të cilat morën pjesë përfaqësuesit të: KFOR-it "LMT", OSBE-së, OJQ-ve, pastaj kryetarja e komunës, Kabineti i kryetares së komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, shefi i Shërbimit për Tatimin në Pronë, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, nënkryetar i komunës për komunitete, drejtori i NPK "Ekologjia", drejtoresha e OTG-së, mediat, banorët dhe zyrtarët e Komunës së Graçanicës.

Në mbledhjet e Kuvendit të komunës janë miratuar gjithsej 60 akte, nga të cilat: 57 vendime, 1 Rregullore nr.01/2024/KG për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale nr.01/2021/KG, 1 Konkluzion dhe 1 Plan lokal i veprimit për barazinë gjinore 2024-2026.

Disa nga aktet më të rëndësishme të miratuara gjatë vitit 2024 janë:

- ✓ Raporti vjetor financiar për vitin 2024,

- ✓ Raporti tremujor financiar për vitin 2024,
- ✓ Rritja e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2023 dhe bartja në vitin 2024,
- ✓ Aprovimi i Marrëveshjes kornizë për bashkëpunim shumëfunksional ndërkomunal,
- ✓ Vendimi nr.42-2024-KG për fillimin e hartimit të Planit lokal të veprimit në mjedis (PLVM) për periudhën 2024-2029,
- ✓ Vendimi nr.51-2024-KG për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2024,
- ✓ Përcaktimi i normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2025,
- ✓ Plani lokal i veprimit për barazinë gjinore 2024-2026,
- ✓ Vendimi nr.16-2024-KG për lirimin nga pagesa e borxhit për dhënien me qira të lokalit afarist në pronësi të Komunës së Graçanicës,
- ✓ Konkluzioni i KK të Graçanicës nr.5666-24 të datës 25.10.2024,
- ✓ Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2025-2027,
- ✓ Raporti gjashtëmujor financiar për vitin 2024,
- ✓ Buxheti i Komunës së Graçanicës për periudhën 2025-2027,
- ✓ Raporti nëntëmujor financiar për vitin 2024,
- ✓ Dy raporte të kryetares së komunës për aktivitetet dhe punën e drejtorisë së Komunës së Graçanicës për periudhën 01.12.2023-31.05.2024 dhe 31.05.2024-30.11.2024,
- ✓ Raportet e punës së drejtorive komunale,
- ✓ Lista e pronave të paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim në vitin 2025,
- ✓ Vendimi për miratimin e Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024,
- ✓ Plani i punës së KK të Graçanicës për vitin 2025,

- Kuvendi e shqyrtoi Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023, si dhe Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

☑ Me Planin vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024 janë paraparë 72 pika për rendin e ditës së Kuvendit, nga të cilat 66 janë diskutuar në mbledhjet, që paraqet 91.66%.

Shërbimi për Çështjet e Kuvendit ia ka dërguar brenda afatit ligjor të gjitha aktet e Kuvendit të komunës Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për vlerësimin e ligjshmërisë dhe të gjitha aktet janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës përveç akteve për të cilat ministria kompetente ka vlerësuar se janë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

MAPL-ja dhe ministrinë e tjera kanë vlerësuar se 5 akte prodhojnë efekt të plotë juridik, ndërsa për 4 akte kanë kthyer përgjigje të mëposhtme:

- 1) Ministria e Kulturës nuk është kompetente për vlerësimin e Rregullores nr.01-2024-KG për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat, ngarkesat dhe gjobot komunale nr.01-2021-KG;
- 2) Vendimi nr.46-2024-KG për dhënien e pëlqimit për lidhjen e Aneksit II ndryshimi dhe plotësimi i Kontratës nr.2345-23 të datës 01.06.2023 për ofrimin e shërbimeve nuk është në kompetencë të Kuvendit të komunës por të pushtetit ekzekutiv;
- 3) Vendimi nr.27-2024-KG për dhënien e pëlqimit ndaj kërkesës për vendosjen e simbolit të komunitetit serb - flamurit kombëtar, me rastin e festës së 28 Qershorit, "Vidovdan", pasi vlerësoi se 28 Qershori nuk është festë zyrtare;
- 4) Vlerësimi i ligjshmërisë ka mbërritur jashtë afatit ligjor më 11 dhjetor, ndërsa Vendimi nr. 41-2024-KG për ndryshimin e destinacionit të parcelës kadastrale nr. 9851-1 ZK LlapllasSellë është publikuar në faqen e komunës më 16 shtator.

✓ Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka dy komitete të përhershme:

Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete.

- Komiteti për Politikë dhe Financa në vitin 2024 mbajti gjithsej 14 mbledhje, nga të cilat, 9 mbledhje të rregullta dhe 5 të jashtëzakonshme.
- Komitetin për Komunitete në vitin 2024 mbajti 12 mbledhje, nga të cilat, 9 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme.

✓ KK i Graçanicës ka formuar edhe 3 komitete të tjera:


- Komitetin për Shërbime Publike (gjatë vitit 2024 mbajti 2 mbledhje të jashtëzakonshme),
- Komitetin për Persona me Nevoja të Veçanta (gjatë vitit 2024 nuk ka mbajtur mbledhje) dhe
- Komitetin për Arsim (gjatë vitit 2024 nuk ka mbajtur mbledhje).

- Këto komitete pasqyrojnë përbërjen partiake të Kuvendit, duke pasur parasysh përfaqësimin e komuniteteve pakicë dhe gjinive.

- Dëgjimet dhe konsultimet publike për buxhetin në vitin 2024

Në periudhën prej 09 – 15 gusht 2024 janë mbajtur 11 dëgjime publike dhe konsultime për buxhetin për vitin 2025 dhe Kornizën afatmesme buxhetore 2025-2027. Sipas vendbanimeve janë mbajtur gjashtë (6) prezantime me qytetarët dhe anëtarët e Këshillave lokale dhe një me: përfaqësuesit e institucioneve shëndetësore; drejtorët e shkollave; komunitetin rom; fermerët dhe bizneset; përfaqësuesit e OJQ-ve. Në dëgjimet publike të buxhetit, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe organi ekzekutiv i komunës prezantuan buxhetin, ndërsa qytetarët shprehën mendimet e tyre për propozimin e buxhetit të komunës dhe shprehën nevojat dhe propozimet e tyre për projektet kapitale.

Duke e informuar opinionin për mbledhjet dhe aktivitetet, Kuvendi i komunës ka mundësuar që qytetarët të marrin pjesë drejtpërdrejt në propozimet dhe marrjen e vendimeve dhe ideve për realizimin e të gjitha nevojave të banorëve lokalë në territorin e Komunës së Graçanicës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević